

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2023

NJOFTIMI I SHKURTUAR I KONTRATËS

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rruga "Viktor Eftimiu", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.
Tel/Faks +355 42 228 349, +355 42 239 295
E-mail info@kesh.al
Ueb-faqe www.kesh.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar – Shërbime – me Mjete elektronike, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomik , ku të gjithë kushtet janë të përcaktuara.

3. Numri i referencës së procedurës /Lotit: NR. REF – 66190-04-14-2023

4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Sigurimi i shëndetit dhe sigurimi nga aksidentet personale të punonjësve të KESH sh.a”.

5. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 54,890,281 (Pesëdhjetë e katër milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e një) Lekë pa TVSH ose 486,271(Katërqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

Shumatorja e çmimeve për njësi është: Lekë pa TVSH ose 793(Shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datë 14/04/2023 është 112.88Lekë/Euro.

6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 (dymbëdhjetë) muaj.

7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 09 /05 /2023 (d/m/v) Ora:10.00.

Shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42 pika 6 të LPP:

Siguria dhe Shëndeti në Punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të punëmarrësve jo vetëm në parandalim të rreziqeve, eliminim të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident por ndërmarrja e hapave konkret në drejtim të sigurimit nga aksidentet dhe kontrollit të shëndetit mbetet orientimi kryesor i AK po aq sa dhe një përmbushje e një detyrimi ligjor. Bazuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor Kesh sh.a është drejtë përfundimit të kontratës së sigurimit të shëndetit dhe sigurimit nga aksidentet personale të punonjësve të Kesh sh.a. Në këtë sigurim mbulohen automatikisht me sigurim punonjësit e Kesh sh.a, përfshirë edhe punonjësit e Njësive të Prodhimit Hec Fierzë, Hec Koman dhe Hec Vau i Dejës.

Referuar situatës aktuale, paraqitet e nevojshme që procedura e kërkuar të realizohet në një afat më të shkurtër (se ajo standarte 35 ditë në këto raste), pra të realizohet për 22 ditë, kërkuar dhe propozuar kjo nga AK duke patur parasysh se kemi të bëjmë me sigurim të shëndetit dhe sigurim nga aksidentet personale të punonjësve të Kesh sh.a dhe Njësive të Prodhimit Hec Fierzë, Hec Koman dhe Hec Vau i Dejës.

Pra jemi në një rast, ku nevoja për shërbime emergjente si Aksidentet në punë ose për shkak të punës, nuk do mund të mbuloheshin deri në nënshkrimin e kontratës nga palët. Argumentuar sa më sipër, AK vendos shkurtimin e afatit për pranimin e ofertave nga 35 ditë në 22 ditë.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ergys Verdho